



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 2634 prot.

Tiranë, më 04/10 /2019

URDHËR  
Nr. 96, datë 04.10.2019

PËR  
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË DHE  
DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË DORËZONJË KANDIDATËT PËR ANËTAR  
TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR” NË NIVEL NJËSIE KRYESORE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,  
TIRANË

Në bazë të nenit 39, 46 e vijues ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 28, 29, 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së nxjerrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Senatit Akademik nr. 57, datë 27.09.2019 “Për nisjen e procedurave për krijimin e Komisionit të Përherëshëm për dhënie e gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në UMT”,

URDHËROJ:

1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për anëtar në Komisionin e Përherëshëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në UMT, janë si më poshtë:
  - a) Të jetë personel akademik me kohë të plotë në njësinë kryesore përkatëse në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
  - b) Të mbajë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.
  - c) Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal.
  - d) Të mos jetë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.
  - e) Të mos jetë marrë masë disiplinore ndaj tij.
  - f) Të mos ketë shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar dhe ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
  - g) Të mos jetë anëtar në më shumë se 2 (dy) komisione të përherëshme.

2. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për aplikim kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në UMT, është si më poshtë:
  - a) Kopje e dokumentit të Identifikimit ID/ Pasaportë.
  - b) Kopje të njësuar me origjinalin të diplomës/dëshmisë së titullit akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” ose vërtetim të lëshuar nga UMT-ja në mungesë të diplomës/dëshmisë.
  - c) Vetëdeklarim i gjëndjes gjyqësore.
  - d) Vetëdeklarim që nuk ka masë disiplinore.
  - e) Vetëdeklarim se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit..” i ndryshuar, dhe ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, si dhe që nuk është anëtar në jo më shumë se 2 (dy) komisione të përhershme.
3. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në strukturat përkatëse zgjedhore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas vendimit të tyre.
4. Ngarkohet Komisioni Institucional Zgjedhor dhe njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**REKTORI**  
**ARBEN GJATA**

